

20151123421

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 26 dhe nenit 47 paragrafi 1 pika 6 nga Ligji për Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12 dhe 43/14), Këshilli i Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

**VENDIM PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E ZËVENDËSIMIT TË
KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE TË CILAT JANË TË PAPËRSHTATSHME
PËR QARKULLIM**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton kriteret për identifikimin e kartëmonedhave dhe monedhave që janë bërë të papërshtatshme për qarkullim (në tekstin e mëtejshëm: kriteret) dhe përcakton mënyrën për zëvendësimin e tyre në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore).

2. Termi kartëmonedha dhe monedha që janë bërë të papërshtatshme për qarkullim në kuptim të këtij vendimi do të thotë kartëmonedha dhe monedha të konsumuara, të dëmtuara dhe të prodhuara me gabim.

3. Bankat Popullore i pranon dhe i këmben kartëmonedhat dhe monedhat të cilat janë bërë të papërshtatshme për qarkullim.

4. Bankat dhe kompanitë për furnizim me para të gatshme (në tekstin e mëtejshëm: qendra për para të gatshme) janë të obliguara që ti dorëzojnë në Bankën Popullore kartëmonedhat dhe monedhat të cilat janë bërë të papërshtatshme për qarkullim.

II. KARTËMONEDHAT E KONSUMUARA

5. Të konsumuar konsiderohen kartëmonedhat të cilat:

- gjatë përdorimit janë prishur, holluar, palosur me ç'rast bëhen të buta dhe si të tillë janë të papërshtatshëm për qarkullim.
- në mënyrë të konsiderueshme janë zbardhur, ndotur, është zvogëluar cilësia e letrës dhe ngjyra, prandaj disa nga karakteristikat e tyre themelore (vlera nominale, motivet e kartëmonedhave, elementet e sigurisë) janë dobët të dukshme dhe kartëmonedhat janë të papërshtatshme për përdorim të mëtejshëm.

III. KARTËMONEDHAT E DËMTUARA

6. Të dëmtuara konsiderohen kartëmonedhat të cilat:

- kanë një sipërfaqe të mbetur prej më shumë se 60% dhe kanë të paktën një shenjë të padëmtuar (të dukshme) numerike (numri serial i kartëmonedhës)
- janë të shqyera dhe të ngjitura me shirit ngjitës,
- janë të shqyera në më shumë pjesë dhe të ngjitura me shirit ngjitës, dhe gjatë krahasimit të numrave serik mund të vërtetohet pa diskutim se është e njëjta kartëmonedhë,
- janë të shqyera më shumë se 5 mm,
- që kanë një ose më shumë vrima,
- të cilat janë të shkruara, të vizatuara, të kafshuara, të kalbura, të zbehura për shkak të larjes, të tymosura, të zhubrosura me palosje të shumta,

- janë të lyera me bojë shkrimi , yndyrë, kemikale,
- janë djegur dhe pjesa e djegur është më pak se 40% e sipërfaqes së kartëmonedhës dhe
- janë ngjyrosur me ngjyrë të fortë me të cilën bëhet mbrojtja kimike e kartëmonedhave gjatë transportit, gjegjësisht kur kartëmonedhat nullohen në rast të hapjes së dhunshme të paketimit të kartëmonedhave.

IV. MONEDHA TË KONSUMUARA DHE TË DËMTUARA

7. Monedhat e konsumuara dhe të dëmtuara konsiderohen monedhat që janë bërë të papërshtatshme për qarkullim të mëtejshëm nën ndikimin e një force të jashtme, duke shkaktuar deformime mekanikë prishjen e sipërfaqes së monedhave ose karakteristikat themelore të saj janë pak të dukshme nën ndikimin e dëmtimeve kimike dhe janë të papërshtatshme për qarkullim të mëtejshëm.

V. KARTËMONEDHAT DHE MONEDHAT E PRODHUARA ME GABIM

8. Kartëmonedha dhe monedha të prodhuara me gabim janë ata ekzemplar të kartëmonedhave dhe monedhave të bëra me disa gabime dhe si të tilla lëshohen në qarkullim.

VI. MËNYRA E ZËVENDËSIMIT TË KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE TË KONSUMUARA DHE TË DËMTUARA

9. Bankat dhe qendrat për para të gatshme janë të obliguara të përpunojnë kartëmonedha dhe monedha, ndërsa ekzemplarët e kartëmonedhave dhe monedhave që gjatë përpunimit janë përcaktuar si të papërshtatshme për qarkullim në bazë të kriterëve të këtij vendimi, tëprhiqen nga qarkullimi, paketohen dhe dorëzohen në Bankën Popullore.

10. Bankat nëpërmjet njësive të tyre organizative pranojnë dhe kryejnë zëvendësimin e kartëmonedhave dhe monedhave që janë të papërshtatshme për qarkullim nga personat fizikë dhe juridikë.

11. Kartëmonedhat dhe monedhat që janë të papërshtatshme për qarkullim, nuk mund përsëri të lëshohen në qarkullim dhe në mënyrë obligative dorëzohen në Bankën popullore.

12. Banka Popullore përpunon kartëmonedhat dhe monedhat që janë të papërshtatshme për qarkullim dhe kryen zëvendësimin e tyre.

13. Banka Popullore kryen zëvendësimin e kartëmonedhave dhe monedhave të papërshtatshme për qarkullim nëse plotësojnë kriteret e parapara në këtë vendim.

14. Kartëmonedhat e dëmtuara që do të identifikohen gjatë përpunimit në Bankën Popullore, shkalla e dëmtimit të së cilave është më e madhe se sa kriteret e përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, do të konsiderohen si mungesë.

15. Bankat dhe qendrat për para të gatshme, në bazë të raportit të përgatitur nga Banka Popullore, duhet të kompensojnë mungesën e përcaktuar në afat prej tri ditë pune, nga marrja e tij.

16. Banka Popullore zëvendëson monedhat e dëmtuara nëse është e mundur të përcaktohet origjinaliteti i tyre (duke pasur parasysh madhësinë, peshën, ngjyrën, përzierjen, gdhendjen dhe shenjat e tjera).

17. Banka Popullore zëvendëson në shumë të plotë kartëmonedhat dhe monedhat e përpunuara me gabim, pasi ato të dorëzohen nga bankat dhe qendrat për para të gatshme.

18. Banka Popullore kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij vendimi gjatë përpunimit të kartëmonedhave dhe monedhave nga bankat dhe qendrat për para të gatshme, sipas akteve që rregullojnë në mënyrë të ngushtë kushtet dhe mënyrën e ushtrimit të kontrollit.

VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

20. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi për kushtet dhe mënyrën e zëvendësimit të kartëmonedhave dhe monedhave të cilat janë të papërshtatshme për qarkullim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 91/11 dhe 153/12).

21. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

V. nr. 02-15/VIII-4/2015
25 qershor viti 2015
Shkup

Guvernator
dhe Kryetar i Këshillit
të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë,
Dimitar Bogov